



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: sekretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

NJOFTIM PËR POZICIONIN

“Koordinator Terreni ne qytetin e Durrësit (Komponent Volejbol)”

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, themeluar në vitin 1958, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpike Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj.

Në kuadër të Projektit **“Ekipet Sportive 2022”**, projekt i financuar nga Buxheti i Shtetit, KOKSH, fton kandidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës

“Koordinator Terreni ne qytetin e Durrësit (komponent Volejbol)”

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është krijimi i një Programi Kombëtar që nxit 1) sportin masiv, 2) zbulimin e talenteve, 3) edukatën sportive dhe parimet olimpike. Projekti do të formojë Ekipet sportive jashtë shkollore në nivelin 9-vjecar (nga klasa e 6 – 9); në nivelin shkollë e mesme (nga klasa 10 – 12); në universitete.

Detyrat e Koordinatorit te Terreni ne qytetin e Durrësit (komponent Volejbol)”

Detyrat tuaja kryesore në këtë pozicion janë koordinimi i punës të Projektit në sportin që ju mbuloni, ndjekja e afateve dhe organizimi në përgjithësi, komunikimi me të gjitha palët e përfshira në zonën tuaj, komunikimi me bashkinë përkatëse, koordinimi i trajnerëve dhe skuadrave, supervizimi i implementimit të projektit në sportin që ju mbuloni si dhe komunikimi me nxënësit/prindërit. Përgatit raporte dhe paraqet informacionin te drejtori i projektit apo personat e interes, si dhe zbaton detyrat e deleguara nga Drejtori i Projektit. Për këtë arsye, duhet të jeni të organizuar dhe të keni aftësi të shkëlqyera të menaxhimi. Në këtë pozicion do të jeni përgjegjës dhe për koordinimin e kalendarit të eventeve dhe menaxhimin e afateve kohore për organizimin e aktiviteteve.





Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: secretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

Kualifikimet dhe Eksperienca:

- Arsim i lartë, minimalisht niveli bachelor, preferohet Universiteti i sporteve.
- Të ketë 3-5 vite eksperiencë profesionale në menaxhim/organizim apo sport.
- Njohuri shumë të mira të paketës MS Office;

Aftësi dhe kompetenca kryesore

- Të ketë aftësi shumë të mira komunikuese dhe organizative;
- Preferohet të njohë mire fushën e sportit në zonën gjeografike që mbulon.
- I/E aftë të punojë në mënyrë të pavarur; Etikë pune dhe përpikmëri.

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin Europass;
- Letër Interesi;
- Fotokopje të diplomave universitare;
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dërgojnë dokumentet e aplikimit deri më datë 25 Maj 2022, ora 16.00, në adresën secretary.general@nocalbania.org.al , me subjekt: **Aplikim për pozicionin Koordinator Terreni ne qytetin e Durrësit (Komponent Volejball) “Ekipet Sportive 2022”**

